

**Dr. Hasan Saliu\***

## **Transformimi i mediave lokale në Kosovë dhe debatet për çështje publike**

### **Abstrakt**

Për ta ushtruar aktivitetin e tyre mediatik, televizionet në Kosovë duhet të licencohet në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM). Ky organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimeve, lëshon licenca për televizione nacionale, regjionale dhe televizione lokale. Por, Kosova e ka pasur si kusht nga Konferenca e Gjenevës që të kalojë televizionet në platformën digjitale të transmetimeve deri në qershor 2015, gjë e cila nuk ka ndodhur.

Punimi trajton këtë fazë kalimtare dhe transformuese nëpër të cilën kalon vendi i cili nuk është as anëtar i Unionit Ndërkombëtar të Transmetimeve (ITU) ndonëse merr përsipër detyrimin e rregullimit frekuencor. Në këtë periudhë tranzicioni nga transmetimet analoge drejt transmetimit digjital, televizionet lokale në Kosovë, ndonëse me licencë lokale, arrijnë që programet e tyre t'i ofrojnë në të gjithë Kosovën në sajë të veprimit të operatorëve kabllorë. Por, programi dhe cilësia e tij mbeten për të dëshiruar. Debatet për çështje publike në televizionet lokale ose huazohen nga televizionet me frekuenca nacionale, ose debati shndërrohet në hapësirë vetë-reklamuese për politikanin. Megjithatë, televizionet lokale që mbushin programacionin e tyre me muzikë e filma, vazhdojnë të mbijetojnë në periudhën e transitore, para kalimit të platformën digjitale.

**Fjalë kyç:** Televizione lokale, digjitalizim, operatorë kabllorë, ofrues të shërbimeve audiovizuale, debate, pseudodebate etj.

---

\*Kolegji AAB, Prishtinë, email: hasan.saliu@aab-edu.net

## Hyrje

Kosova vetëm pas hyrjes së NATO-s në vitin 1999, rihapi tregun mediatik. Deri në atë kohë televizioni i vetëm shtetëror i mëparshëm, Televizioni i Prishtinës, ka qenë i mbyllur për një dhjetëvjeçar nga autoritet serbe. Me vënien e Kosovës nën mbikëqyrje ndërkombëtare, misioni i OKB-së (UNMIK) dhe OSBE-ja në bashkëpunim me Unionin Evropian të Transmetimeve (EBU), fillojnë transmetimin e Radio Televizionit publik të Kosovës (RTK)<sup>2</sup>. Pak muaj më vonë transmetimet i fillojnë edhe dy televizione të tjera private, RTV21 dhe Koha Vizion (KTV). Këto tre televizione të licencuara në vitin 2000, mbeten edhe sot e kësaj dite të vetmet televizione me shtrirje nacionale që emetojnë nëpërmjet frekuencave analoge tokësore. Të gjithë televizionet e tjera janë lokale ose kabllore.

Të drejtat dhe detyrimet e transmetuesit publik në Kosovë janë bërë pjesë të Planit Ahtisari, në bazë të të cilit dokument ky vend shpalli pavarësinë shtetërore. Detyrimi që Kosova të ketë televizion publik dhe një kanal të veçantë për pakicën serbe, u kooptua edhe në kushtetutën e shtetit të pavarur si dhe në ligjin për transmetuesin publik.

Por, përveç këtyre detyrimeve, ndërkombëtarët nuk hapën tregun televiziv nëpërmjet frekuencave analoge tokësore, sepse deri vonë, përgjegjës i frekuencave ishte Komisionari i Pavarur i Mediave i drejtuar nga një ndërkombëtar i deleguar<sup>3</sup>. Gjendja nuk ndryshoi edhe kur kompetencat u kaluan vendësve me formimin e Komisionit të Pavarur të Mediave (2005), si i vetmi institucion kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Kosovë. Për t'iu përgjigjur kërkesave për hapjen e

---

<sup>2</sup> Hasan Saliu, “Kuadri ligjor i televizioneve në Kosovë”, në: *Historia e medias dhe mediatizimi i historisë* - Universiteti i Tiranës-Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë-Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Tiranë, V/2012, f. 195.

<sup>3</sup> Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave. I qasshëm edhe në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20KPM.pdf>

televizioneve të reja, ky organ si mundësi gjeti licencimin e televizioneve në valë-shpërndarjen kabllore, siç është edhe sot.

Aktualisht në Kosovë operojnë 56 televizione lokale dhe rajonale; 4 kanale i ka transmetuesi publik (RTK), ndërsa vetëm 3 kanale kanë licencë me shtrirje analoge nacionale: RTK, KTV dhe RTV21. Sipas ligjit, ripërtëritja e tyre bëhet për një afat shtatë (7) vjeçar për radio transmetime, ndërsa për shërbime mediale audiovizuale dhe për operatorët e rrjeteve për ofrimin e shërbimeve mediale me përmbytje audiovizuale, afati është dhjetëvjeçar<sup>4</sup>. Shumica e këtyre kanaleve televizive janë të përqendruar në Prishtinë. Nga 56 televizione të licencuara, 43 prej tyre kanë dhënë Prishtinën si adresë të përhershme të selisë së televizionit. Të tjerët, nga një apo dy televizione shpërndahen në qytetet si: Gjilan, Fushë Kosovë, Drenas, Mitrovicë, Çagllavicë, Prizren etj<sup>5</sup>. Emërtimi i televizioneve si —nacional”, —rajonal” dhe —lokal” në Kosovë ka një kuptim jo të qartë plotësisht për nga aspekti i shpërndarjes së sinjalit televiziv. Televizione lokale mendohet për ata ofrues të shërbimeve audiovizuale të cilat sinjalin e shtrirjes analoge e kanë brenda një komune dhe paguajnë një taksë vjetore prej 533 eurosh për kabllorët, por nëpërmjet operatorëve kabllore këta transmetues kapërcejnë emërtimin e televizionit lokal dhe gjejnë shtrirje në një pjesë të madhe të Kosovës.

Kosova edhe pse me një rrjet të zhvilluar të shpërndarjes së operatorëve kabllore, megjithatë procesi i digjitalizimit ende është duke vazhduar. Vendi nuk është anëtar ITU (International Telecommunication Union), por zbaton politikat e saj, ndërkaq afatin e fundit të kalimit të plotë në platformën digjitale e ka pasur deri në qershorin e vitit 2015. Sipas ligjit për Komisionin e Pavarur të

---

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup>Shih Adresari i ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuale të licencuara në Komisionin e Pavarur të Mediave, në: <http://kpm-ks.org/?faq=370&gjuha=1>

Mediave (KPM), ky organizëm është përgjegjësi kryesor për të gjitha përgatitjet që duhet bërë për kalimin e transmetimit digjital.

### **Debatet televizive**

Televizionin sot e shikon e gjithë bota, flasin për të, e kritikojnë, i besojnë, pa pasur mundësi për ta injoruar<sup>6</sup>. Por, për çfarë qëllimi shërben pjesëmarrja në debat, thjesht për t'u parë, apo pjesëmarrësi ka vërtet diçka për të thënë, analizon problemet në thellësi, apo shkon paraprakisht me mendime të gatuar, apo ato janë thjesht programe argëtuese të projektuar për të mbushur programacionin televiziv<sup>7</sup>? Gjithnjë e më shumë njerëz, anëtarë të publikut dhe të ashtuquajtur ekspertë, shfaqen në televizion për të diskutuar dhe debatuar çështjet editës. –Që gjysmë shekulli, televizioni është objekt suksesi i jashtëzakonshëm, por ai nuk e ka marrë asnjëherë legjitimitetin intelektual që e meriton”<sup>8</sup>.

Kosova, ndërkaq, si vend i cili rishtazi ka fituar lirinë dhe pavarësinë, po bën përpjekje të konsolidojë demokracinë dhe në këtë kuadër edhe lirinë e medias dhe të mëtojë që nëpërmjet debatit, të përmirësojë realitetin shoqëror. Ka një konsum të madh të produktit televiziv, aq më shumë e varur nga informacioni politik për shkak të rrethanave specifike që ka me konsolidimin e shtetësisë, njohjet, problemet territoriale në veri dhe forcimin e demokracisë. Ndonëse vetëm me tre televizione që kanë licencë frekuencash të shtrirjes në të gjithë territorin, megjithatë futja e kabllorit ka plotësuar boshllëkun e ofertës së kufizuar televizive, edhe me depërtimin e dy platformave

---

<sup>6</sup> Dominique Wolton, *La télévision au pouvoir*, <http://video-streaming.orange.fr/actu-politique/dominique-wolton-la-television-au-pouvoir-VID0000000Asmt.html>

<sup>7</sup> Livingstone, Sonia & Lunt, Peter. “The mass media, democracy and the public sphere”. Në: *Talk on Television: Audience participation and public debate* (9-35). London: Routledge. 1994, f.1.

<sup>8</sup> Dominique Wolton, *La télévision au pouvoir*, <http://video-streaming.orange.fr/actu-politique/dominique-wolton-la-television-au-pouvoir-VID0000000Asmt.html>

digjitale televizive nga Shqipëria. Së fundmi, një televizion kabllor gjithnjë e më shumë po gjen hapësirën e saj për të depërtuar te publiku si televizion me shtrirje nacionale, ndonëse pa frekuenca dhe pa sinjal te konsumatori rural ku mungon rrjeti kabllor televiziv.

Por, Kosova është e njohur për debate jo shumë përmbajtësore në jetën publike. E dalë jo përfundimisht nga një mbikëqyrje ndërkombëtare, debatet për çështje të rëndësishme shoqërore, konstitucionale, ekonomike etj., deri vonë përfundonin shpesh duke iu referuar ndërkombëtarëve për probleme të mprehta në shoqëri. Megjithatë, debatet televizive për çështje të tjera ndoshta jo të interesit jetik shtetëror, janë të pranishme në 3-4 televizionet e vendit. Ato organizohen në televizionin publik (RTK), privatët Koha Vizion (KTV), RTV21 dhe Klan-Kosova. Në shumicën e debateve diskutojnë njerëz të njëjtë në studio, për fusha nga më të ndryshmet dhe pa asnjë kompetencë profesionale.

Drejtuesit e emisioneve zakonisht tregohen të kujdesshëm për personat që ftojnë në studio. Dominojnë kryesisht njerëz të politikës të cilët prezantojnë platformën e partisë dhe të cilët për çështjet e diskutueshme kanë mendime paraprakisht të gatuar. Debatet ku marrin pjesë politikanë, i ngjajmë më shumë ripërtypjes së platformës politike të bërë publike që në fushata të mëhershme zgjedhore. Politikani në studio merr detyrën që të bëjë —përfaqësim dinjitoz” të subjektit në emër të të cilit ai flet, siç do të kishte thënë Bourdieu<sup>9</sup>, ”me klishe apo ide të pranuar...” paraprakisht dhe të gatuar nga partitë. Diskutuesi nuk mund të zgjerohet përtej linjës që ka tërhequr subjekti i cili e ka dërguar dhe kjo shihet kur mysafiri fillon e përsërit gjerat e thëna më herët.

Në debate marrin pjesë opinionistë të emërtuar analistë dhe të cilët përzgjidhen varësisht nga provenienca. Dhe, këtu ndarja është e evidente. Këta opinionistë janë gazetarë të punësuar në media të ndryshme, kryesisht gazeta. Nga një hulumtim personal të kryer kohë

---

<sup>9</sup> Pierre Bourdieu, *On Television*, New Press. New York: 1998, f. 29.

më parë<sup>10</sup>, vetëm dy gazeta (nga 10 që ishin atëkohë), kishin më pak reklamë publike- qeveritare sesa reklamë nga subjektet private. Te të gjitha të tjerat dominonte dukshëm reklama nga fondet publike. Pjesëmarrja në debatet televizive kryesisht e këtyre gazetarëve që vijnë nga media të caktuara, identifikon shpesh anësinë e tyre dhe mbështetjen që i japin ata një subjekti të caktuar, apo qeverisë. Kjo është e vetëkuptueshme për Televizionin publik (RTK), i cili financohet drejtpërdrejt nga Ministria e Financave, ndërsa ka zëra të vazhdueshëm nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë të cilët kanë ngritur shqetësimin për ndikimin që ushtron politika qeveritare ndaj mediumit publik. Një televizion tjetër, Klan-Kosova ka pasur një grup standard opinionistësh të cilët diskutojnë për çështje nga më të ndryshmet, ndërsa njihen si të afërt me qarqe qeveritare. Këta gazetarë, redaktorë dhe drejtues gazete që me muaj apo edhe vite zhvillonin debate, edhe më herët, më pas u katapultuan në politikë dhe zunë poste ministrash, zëvendësministrash e ambasadorësh. Disa prej tyre mbetën në politikë e disa të tjerë u rikthyen dhe sot bëjnë —analistin” në studio të ndryshme televizive. Debatet i mirëfilltë intelektual këtu ka dëshmuar të mungojë si pasojë e strukturës së pronësisë së mediumit. Struktura e pronësisë, siç thotë Bourdieu, luan një rol të rëndësishëm në censurën e padukshme të medias. —Me vetëdije apo pa vetëdije, njerëzit censurojnë vetveten, pa qenë nevoja që dikush t’ua kërkojë atë”<sup>11</sup>. Dhe, në Kosovën me një ekonomi të pazhvilluar dhe media jo fort të fuqishme dhe pa stabilitet financiar, ndodh që gazetarët të brendësojnë në redaksi autocensurën e cila i imponohet nga pasiguria e ruajtjes apo gjetjes së një pune të re në media. Punëdhënësi - shtet vazhdon të mbetet punëdhënësi më i madh dhe i sigurt në Kosovë, ndërsa shumë gazetarë nëpër media ose nuk kanë kontrata, ose rrogat i marrin me vonesa të mëdha. Thënia e

---

<sup>10</sup>Hasan Saliu, —Ndikimi financiar mbi shtypin në Kosovë”, në:  
*Mediat shqiptare në tranzicion* - Studime Albanologjike, Universiteti  
i Tiranës-Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë-Departamenti i  
Gazetarisë dhe Komunikimit, Tiranë, 2010/3.

<sup>11</sup> Bourdieu, Pierre. *On Television*, New York: New Press. 1998, f. 15.

Bourdieu-së se —...nejemidëshmitarë tërritjes së madhe të një subproletariati gazetaresk, e forcuar nga një lloj autocensure nga rritja e situatës së pasigurisë në punë<sup>12</sup> del të jetë mjaft e pranishme në gjendjen e disa mediave lokale apo edhe rajonale e nacionale në Kosovë. Por, edhe —nacistët në ekran<sup>13</sup> gjen praktikum te disa drejtues debatesh. Madje, një drejtues i tillë ka pasqyrë në studio dhe kamerat japin pamjen e tij në mënyrë dy-dimensionale. Promot e këtij debati zakonisht japin drejtuesin dhe pasqyrën ku sërish shihet drejtuesi i emisionit. Siç thotë Habermas —...pubiku përthithet në një publicitet të demonstruar ose të manipuluar jo nga komunikimi publik, por nga komunikimi i opinioneve të manifestuar publikisht<sup>14</sup>.

### Niveli i debateve televizive

Debatet televizive në përgjithësi prekin çështjet e ndjeshme politike, por televizionet shpesh janë munduar të vendosin agjendën e tyre varësisht nga interesi i pronarit. Televizioni publik i cili vazhdon të ketë një shikueshmëri më të madhe sesa televizionet e tjera publike në rajon, është më i kritikuari se —fshëh duke treguar”. Përderisa Kosova përballlet me çështje mjaft të rëndësishme si: mungesa e plotë e sovranitetit shtetëror në veri të vendit, rënia e vazhdueshme ekonomike, rënia e vazhdueshme e ndihmave financiare nga jashtë, mungesa e investimeve të huaja, me gati gjysmën e popullsisë të papunë etj., shpesh kërkon të përqendrojë vëmendjen në çështje dytësore. Në vend të këtyre temave, kohëve të fundit shihen debate të cilat kanë të bëjnë me BE-në dhe institucionet e saj, ndërsa Kosova mbetet i vetmi vend në kontinent pa liberalizim vizash dhe e cila problematikë është thuarje e padiskutuar në thelb dhe nga ekspertë. Në raste të tilla, televizioni, siç thotë Popper<sup>15</sup>, —kërkon gjithnjë e më

---

<sup>12</sup> Po aty, f. 6.

<sup>13</sup> Cif. Bourdieu.

<sup>14</sup> Jürgen Habermas, *Storia e critica dell'opinione pubblica*. Laterza. Roma: 2006, f. 285.

<sup>15</sup> Popper, Karl & Condry John. *Cattiva maestra televisione*, [http://www4.ti.ch/fileadmin/DECS/DS/Rivista\\_scuola\\_tici](http://www4.ti.ch/fileadmin/DECS/DS/Rivista_scuola_tici)

shumë të lansojë një produkt sa më të skaduar”. Në raste të tilla, debatet marrin pamjen e reklamuesit politikë, sesa të diskutohet për çështjet vërtet të ndjeshme dhe të dobishme për opinionin. Praktikisht bëhet, siç i quan Fuga, —aktivizim të fushatave të marketimit politik”<sup>16</sup>.

Se televizioni fsheh duke treguar, kjo shihet mjaft qartë te debatet në televizionet e Kosovës. Shumë nga debatet përmbajtësore dhe për çështje kruciale, si ato të krimit e korrupsionit, shpesh janë më gjithëpërfshirëse në televizionet e Shqipërisë që diskutojnë për Kosovën dhe me mysafirë nga Kosova, sesa në televizionet vendore. —Kur ju përdorni kohën për të thënë gjëra banale, kjo ndodh pasi këto gjëra të kota janë në fakt shumë të rëndësishme për sa kohë që fshehin gjëra të tjera të rëndësishme”<sup>17</sup>.

Shumica e televizioneve lokale kanë një programacion të huazuar sesa një produkt të vetin televiziv. Koha më e madhe e transmetimit plotësohet me filma, me muzikë ose me program të huzuar. Shumica e televizioneve lokale nuk kanë as edicion të lajmeve, ndërsa disa prej tyre kanë debate televizive për diskutime për çështje publike. Mysafirët në studio vijnë kryesisht nga jeta publike dhe politike, ndërsa ka raste të shpeshta që intervista nga aktorë politikë të merren nga televizionet e tjera dhe të ritransmetohen në televizionet lokale. Por, edhe debatet në televizionet e tjera kanë specifikat e veta. Në këto debate shpesh ka shmangie jo vetëm nga thellimi në problematikë, por madje edhe mediat përzgjedhin persona joadekuatë ose jo shumë të afërt me problematikën që diskutohet.

### **Përfundime**

Televizionet lokale në Kosovë paraqesin një dëshirë e pronarit mediatik për ta poseduar atë pavarësisht se programacioni mbushet

---

[nese/ST n.200/ST 200 Fazioli Biaggio cattiva maestra televisione.pdf](#)

<sup>16</sup> Artan Fuga, “Mediapolitika”. Gazeta Standard. Tiranë: 28 prill 2012.

<sup>17</sup> Bourdieu, vep.cit. f. 18.



me muzikë, filma apo me produkt të huazuar dhe mediokër. Kalimi i tyre në platformën digjitale mbetet një sfidë duke pasur parasysh koston që përfshin digjitalizimi.

Ndërkaq, debatet televizive në Kosovë mbeten prapa debateve të cilat shpesh trajtohen në shtypin e shkruar. Koha, e kufizuar, urgjenca televizive, për zgjedhja e njerëzve që flasin në televizion, ka bërë që diskutimet të jenë vërtet sipërfaqësore, ndërsa vërehen diskutues që mezi e marrin një herë fjalën. Të qenit peng i audimatit, edhe pse në Kosovë nuk ka matje serioze të audimatit, njëherësh ul cilësinë e produktit televiziv. Struktura e pronësisë kërkon që media si një biznes, të kërkojë kanalet e sponsorizimit, ndërsa mungesa e bizneseve të fuqishme në Kosovë afron mediat me politikën, ose edhe politikanë qeveritarë që stimulojnë financiarisht media të caktuara.

Përveç pronësisë, një specifikë tjetër në mediat e Kosovës është edhe prania e madhe e gazetarëve – studentë dhe politikanëve ish-luftëtarë të futur në politikë, një pjese të cilëve u mungon shkollimi adekuat dhe kjo gjithashtu ul elokuencën dhe cilësinë e debatit.

### **Bibliografia**

Bourdieu, Pierre. *On Television*, New York: New Press. 1998.

Fuga, Aartan. —“Mediapolitika”. *Gazeta Standard*. Tiranë: 28 prill 2012.

Habermas, Jurgen. *Storia e critica dell'opinione pubblica*. Laterza. Roma: 2006.

Livingstone, Sonia & Lunt, Peter. —“The mass media, democracy and the public sphere”. Në: *Talk on Television: Audience participation and public debate* (9-35). London: Routledge. 1994.

Popper, Karl & Condry John. *Cattiva maestra televisione*, [http://www4.ti.ch/fileadmin/DECS/DS/Rivista\\_scuola\\_ticinese/ST\\_n.200/ST\\_200\\_Fazioli\\_Biaggio\\_cattiva\\_maestra\\_telemuseo.pdf](http://www4.ti.ch/fileadmin/DECS/DS/Rivista_scuola_ticinese/ST_n.200/ST_200_Fazioli_Biaggio_cattiva_maestra_telemuseo.pdf)(vizituar: 24 janar, 2017)

Saliu, Hasan.—“Ndikimi financiar mbi shtypin në Kosovë”. Në: *Mediat shqiptare në tranzicion - Studime Albanologjike*, Universiteti i Tiranës-Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë-Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit. Tiranë. 2010/3, (144-149).

Saliu, Hasan. –“Kadri ligjor i televizioneve në Kosovë”, në:  
*Historia e medias dhe mediatizimi i historisë* - Universiteti i Tiranës-  
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë-Departamenti i Gazetarisë dhe  
Komunikimit. Tiranë. V/2012 (195-202).

Wolton, Dominique. *La télévision au pouvoir*. Në: <http://video-streaming.orange.fr/actu-politique/dominique-wolton-la-television-au-pouvoir-VID0000000Asmt.html>(vizituar: 24 janar, 2017)